- 49-Te gjitha Llojet e Sistemeve , etj
- 50-Te gjitha llojet e modemave , etj
- 51-SAP Vlerësimi i ceneshmërisë + Testimi i depërtimit
- 52-Testimi i depërtimit në rrjet
- 53-Testimi i depërtimit të VoIP
- 54-Simulimi i kundërshtarit
- 55-Testimi i plotë i spektrit , Rishikimi dhe Shërbimet e Kerkim Zhvillimit
- 56-Te tjera

## DISIPLINAT E M S I

I-Inteligjenca njerëzore




- 1-Inteligjenca njerëzore
- 2-Inteligjenca e sinjaleve
- 3-Inteligjencë me burim të hapur
- 4-Inteligjenca e imazheve / Inteligjenca gjeohapësinore
- 5-Matja dhe inteligjenca e gjurmëve
- 6-Inteligjenca teknike
- 7-Inteligjenca mjekësore
- 8-Inteligjenca financiare
- 9-Inteligjenca kibernetike ose e rrjetit dixhital
- 10-Inteligjenca kulturore
- 11-Inteligjenca e tregut
- 12-Kundërzbulimi
- 13-Inteligjenca kriminalistike
- 14-Inteligjenca Speciale
- 15-TE TJERA

Kompania do të merret me import -eksport , tregtimin e të gjitha llojeve të artikujve të ndryshëm me shumicë dhe pakicë për ushtrinë dhe policinë dhe agjencitë e inteligjencës si : armëve dhe armatimit ushtarak të çdo kalibri , teknologjise ushtarake speciale , uniforma për policinë dhe ushtrinë , etj , sisteme vëzhgimi , survejimi , sisteme interceptimi , sisteme gjurmimi , antiplumba , paisje gjurmuese , dylbi , paisje elektronike , bllokues valesh , paisje kundër bllokimit të valeve , etj , gjurmues , kundërgjurmues , avjona të telekomanduar , paisje të telekomanduara , krijimin dhe paisjen e poligoneve ose objekteve dhe ambjentëve të testimit dhe stërvitjes së punonjësve të kompanisë por edhe të forcave të armatosura të ushtrisë , agjencive të inteligjencës dhe agjencive ligjzbatuese dhe paisjen e tyre me teknologji me të fundit si dhe çdo aksesor tjetër të nevojshëm për policinë dhe ushtrinë dhe agjencitë e inteligjencës dhe çdo paisje për të përmbushur misionin e kompanisë .

Kompania do të kryejë misione dhe operacione të çdo lloji dhe të ndryshme civile dhe ushtarake dhe detyra .

**MSI do të merret me :**

- 1-Mbrojtjen Sigurine Inteligjencen
- 2-Mbrojtjen e Sigurise Kushtetuese dhe Juridike





- 3-Mbrojtjen e Sigurise se Informacionit
- 4-Mbrojtjen e Sigurise se Dokumentacionit
- 5-Mbrojtjen e Sistemeve te Komunikimit
- 6-Mbrojtjen e Sistemeve te Informacionit dhe Teknologjise
- 7-Mbrojtjen e Sinjaleve
- 8-Mbrojtjen e Kodeve te Enkriptimit
- 9-Mbrojtjen e Sigurise Njerezore
- 10-Mbrojtjen e Sigurise Fizike dhe te Objekteve
- 11-Mbrojtjen e rrugës së furnizimit logjistik
- 12-Mbrojtjen e Interesave te Kombit dhe Shtetit ne arenen nderkombetare
- 13-Mbrojtjen e te drejtave Shqiptare brenda dhe jashte vendit
- 14-Mbrojtjen e te drejtes se Kombesise dhe marrjen e Pashaportes Shqiptare per cdo individ qe eshte Shqiptar kudo qe ndodhet ne bote si e drejte Kushtetuese e pakundershtueshme .MSI do asistojë dhe ndihmojë cdo individ ne marrjen e kombesise dhe shtetesise Shqiptare dhe pashaportes shqiptare .
- 15-Mbrojtjen e sigurise se Pronesise dhe te dokumentacionit te Pronesise
- 16-Mbrojtjen e Sigurise Ushqimore dhe Ujore
- 17-Mbrojtjen e Sigurise Mjedisore
- 18-Mbrojtjen e Historise , Kultures , etj
- 19-Mbrojtjen e Sigurise Kibernetike
- 20-Etj

MSI do te kryejë detyra te vecanta si me poshte :

Kompania rreshtohet se bashku me forcat e armatosura te ushtrise ,agjencive te inteligjences dhe agjencive ligjzbatuese me qellim qe te kenaqi strategjine ushtarake dhe te inteligjences duke arritur objektivat strategjike ,operacionale dhe taktike .Kjo mund të përfshijë jo vetëm kontributin strategjik ushtarak dhe te inteligjences dhe këshilla dhe mbështetje në të 3 nivelet : Strategjike , Operacionale dhe Taktike por dhe ne nivelin teknologjik .

Në nivelet Strategjike , Operacionale , Taktike , Teknologjike kompania ofron raportim të kërcënimeve dhe inteligjencës , misionet e zbulimit , misione shpetimi , vleresimet e menaxhimit te rrezikut te projektit , planifikimi i emergjencave te parashikuara dhe te paparashikuara , rikuperimi dhe stabilizimi strategjik i objektivit , negociata te pengjeve , sigurinë e aviacionit , sigurinë detare , sigurine tokesore , sigurinë e vendit , sigurine e vendeve te takimit , mbrojtjen e personave te rendesishem ,





shoqërimin e personelit dhe pajisjeve dhe kështu me radhë .MSI informon ne kohe reale sherbimet ushtarake ,sherbimet e inteligjences dhe sherbimet ligjzbatuese per teknologjite me te fundit .

Kompania ndërmerr detyra të shumta dhe të veçanta . Këto përfshijnë por nuk kufizohen në :

Këshilla dhe zhvillimi i strategjisë në nivelet politike , ushtarake, të inteligjencës dhe të zbatimit të ligjit .

Zhvillimi i doktrinës dhe integrimi i taktikave .

Rishikimet dhe strukturimi i njësive të reja dhe njësive shtesë .

Konsultimet për menaxhimin e rrezikut .

Kujdesin e duhur .

Planifikimi strategjike , operacionale dhe taktike .

Planifikimi dhe implementimi i procedurave emergjente .

Këshilla strategjike , operacionale , taktike dhe teknologjike .

Misionet e Negocimit dhe Lirimit të Pengut .

Planifikimi , Zbatimi , Menaxhimi dhe Vlerësimi i Sigurisë i Misionit të Zbulimit.

Trajnimi i Forcave Ushtarake , Shërbimeve të Inteligjencës dhe Agjencive të Zbatimit të Ligjit .

Programet e ristrukturimit për Forcat e Armatosura, Shërbimet e Inteligjencës dhe Agjencitë e Zbatimit të Ligjit .

Trajnim dhe këshillim i fshehtë i inteligjencës ( ushtarake, kundër terrorizmit dhe kundër krimit ) . Forca e Reagimit të Shpejte Këshilla, mbështetje dhe trajnime për zbatimin e ligjit. Këshilla dhe mbështetje të prokurimit . Këshilla dhe mbështetje logjistike. Hulumtimi , testimi dhe vlerësimi i pajisjeve. Masat elektronike të kundërveprimit dhe sigurimi i pajisjeve të specializuara. Misione dhe Operacione strategjike , operacionale dhe taktike , zbulimi dhe inteligjence .


Informimin per teknologjite me te fundit , etj .

## **MISIONI :**

Misioni kryesor i MSI është të ndihmojë ne sigurine kombetare te shtetit dhe te klientëve te saj për të arritur paqen , sigurinë dhe stabilitetin , sa më shpejt të jetë e mundur dhe sa më efektive me kosto të ketë e mundur.

Për ta arritur këtë , kompania angazhohet në disa nga misionet më të vështira në mjediset e operimit armiqësor . Kjo perfshin :

Inteligjenca , Kunder Inteligjenca , Kundër-terrorizmi – trajnimi, parandalimi, këshillimi, pengimi, përgjigjja dhe udhezimi .





Operacione sulmuese kundër drogës, trajnimi, parandalimi, këshillimi, pengimi , përgjigjja dhe udhezimi.

Lufta jokonvencionale – strategjia, zhvillimi i doktrinave dhe taktikave, trajnimi, vendosja dhe këshillimi, udhezimi.

Lufta gjysmë-konvencionale – strategjia , zhvillimi i doktrinave, konfirmimi i taktikave , trajnimi , vendosja dhe këshillimi , udhezimi .

Operacionet e fshehta - strategjitë, synimi , zhvillimi i planeve , trajnimi dhe vendosja e aseteve dhe punojesve , menaxhimi dhe këshillimi , udhezimi .

Lufta Kibernetike, Etj

Roli i MSI në këshillimin , asistimin dhe ndihmën e Forcave të Armatosura Kombëtare, Shërbimet e Inteligjencës dhe Agjencite e Zbatimit të Ligjit me ushtrime ristrukturimi , zhvillimin e doktrinës dhe programit , zgjedhjen e platformës së armëve dhe armëve , trajnimin dhe taktikat për të arritur qëllimet e tyre të dëshiruara. Në nivelet strategjike, operacionale, taktike , teknologjike përvoja dhe këshillat e MSI do kërkohen vazhdimisht .

MSI ofron Mbrojtje , Siguri , Inteligjence për klientët , pasuritë dhe zona te caktuara , objekte , etj private dhe shtetërore .

Ekipeve tona të Mbrojtjes , Sigurisë , Inteligjences janë shumë të trajnuar dhe veprojnë brenda ligjeve .

**MSI kryen detyra te mbrojtjes si :**

Mbrojtje te zyrtarëve të lartë të qeverisë , biznesit , individeve, dhe Objekteve Shtetërore dhe Private ( Me vlera të larta ) .

Evakuimi emergjent dhe mbrojtja e personelit nga rrethinat armiqësore .

Mbrojtja e ekipeve dhe rikuperimi i pajisjeve , etj dhe njerezve në mjedise armiqësore .

Mbrojtja e pikave kryesore , kyce , strategjike .

Shoqërimi dhe mbrojtja e stafit të medias në zonat e rrezikut .

Vlerësimi i mbikëqyrjes elektronike dhe mbrojtja e zonave me vlerë të lartë ose ambiente dhe zona të kufizuara .


Sigurimi i vendit ose ambjenteve .

Mbrojtja e Portit , Aeroportit dhe Kufirit .

Mbrojtja e Infrastruktures Kritike .

Transportimi i vlerave monetare dhe te Sendeve me vlerë ose te cdo produkti tjetër brenda dhe jashtë vendit .

Survejimi , Identifikimi , Interceptimi , Gjurmimi me drone ose robot .





Mbrojtja e rrugës së furnizimit logjistik .  
Furnizimi logjistik civil dhe ushtarak .  
Mbrojtje Siguri Inteligjence per Forcat e Armatosura te  
Ushtrise dhe Agjensite e Inteligjences dhe Agjencite Ligjzbatuese .  
MSI do te ofroje Logjistike dhe cdo sherbim qe i nevojitet  
Forcave te Armatosura te Ushtrise dhe Agjensive te Inteligjences per  
Misionet dhe Operacionet e saj .  
MSI do te merret me sigurine ne transport , etj.

#### **TRAJNIMI :**

Ne ofrojmë cdo lloj trajnimi me teknika moderne dhe unike të trajnimit për forcat e armatosura , shërbimet e inteligjencës dhe agjencitë e zbatimit të ligjit .

#### **Misionet tipike të trajnimit te MSI përfshijnë :**

- Lufta e manovrave
- Lufta jokonvencionale
- Lufta gjysmë-konvencionale
- Operacione të fshehta për ekipet e Forcave Speciale dhe Shërbimet e Inteligjencës
- Lufta Urbane
- Operacion Inteligjence , Zbulimi , Survejimi , Gjurmimi , Interceptimi
- Trajnimi ajror
- Trajnimi i snajperit
- Trajnim për Mbrojtjen e personave me rëndësi te vecante

Armët dhe Taktikat e Veçanta për e Forcat e Armatosura Kombëtare , Shërbimet e Inteligjencës dhe Agjencitë e Zbatimit të Ligjit

- Trajnim kundër narkotikëve
- Trajnim kundër terrorizmit
- Trajnim për lirimin e pengjeve
- Trajnim për sigurinë kibernetike dhe luften kibernetike
- Trajnimi i zhytësave per misione nenujore
- Trajnimi per Mbrojtjen Sigurine Inteligjencen
- Etj

Kompania do merret dhe me fushatat e financimit te kompanise duke mbledhur fonde investimi per te financuar Projekte , Programe , Platforma , Sisteme , Produkte , Sherbime , etj qe ka te beje me sektorin e kompanise te permendura me lart por edhe ne fusha te tjera ku interesohet





kompania ne te ardhmen .

Shoqëria mund te bleje dhe kompani te tjera dhe mund te kryeje dhe veprimtari te tjera qe nuk jane shkruar me siper si dhe veprimtari te tjera ndihmese te cilat mbeshtesin arritjen e qellimit te saj kryesor ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi .

#### **Neni 4**

#### **Kohëzgjatja**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pakufizuar , duke filluar nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare te Biznesit .

#### **Neni 5**

#### **Selia**

Shoqëria e ka selinë në adresën : Njësia Administrative Nr. 10 , Rr. " Reshit Çollaku " , P.Shallvare , H.7 , Ap.97 , Tiranë.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj , të hapë zyra përfaqësie , degë , si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë , vetëm me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

### **KREU II**

### **KAPITALI**

#### **Neni 6**

#### **Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i shoqërisë është 200,000 lekë dhe është i përbërë nga 1 kuotë .

Zoterues i kuotave te kapitalit ne masen 100% është Z. Erland Mara , lindur më 28.04.1992, banues në Tiranë, e identifikuar nga pasaporta me Nr.personal J20428091E.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme .

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë .





Ortaku , që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë , ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cënimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar , si pasojë e cënimit të këtyre të drejtave . Kjo e drejtë parashkruhet brenda 3 vjetëve nga çasti i cënimit. Ortakët e shoqërisë përgjigjen për detyrimet kundrejt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tyre në kapitalin e saj .

## Neni 7

### Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave

7.1. Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

Kontributit në kapitalin e shoqërisë;

- Shitblerjes;
- Trashëgimisë;
- dhurimit;
- çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

7.2. Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

7.3. Ky statut kushtëzon kalimin e kuotave të tretëve jashtë shoqërisë, me miratimin e shoqërisë dhe të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakëve të tjerë, sipas modaliteteve dhe shumicës së kualifikuar që kërkon ndryshimi i statutit.

7.4. Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj në QKR, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

7.5. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.

7.6. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Asambleja e Përgjithshme, me shumicë të kualifikuar, mund të zmadhojë kapitalin themeltar të shoqërisë duke rritur kuotat e ortakëve ekzistues në shumën e përcaktuar në vendimin përkatës. Zmadhimi i kapitalit me qëllim pranimin e ortakëve të rinj, miratohet nga Asambleja e Përgjithshme me shumicën e kualifikuar të votave të ortakëve. Shoqëria mund të vendosë zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të marrë me shumicën e kualifikuar të votave.

## KREU III





## ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

### Neni 8

#### Organi Vendimmarrës

8.1. Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim statuti sipas Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

8.2 Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për :

a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë; b) ndryshimet e statutit; c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;

ç) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar; d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e sipër përmendur në shkronjat “c” dhe “ç”

dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratori, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë; miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë; zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit; pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre; përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve; riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë; miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë; çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

8.3. Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

8.4. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

### Neni 9


#### Mënyra e thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme

9.1. Asambleja e Përgjithshme thirret nga Administratori nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose nëpërmjet e-mail. Njoftimi me shkresë apo me postë elektronike duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes, rendin e ditës dhe t’u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

9.2. Kur Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

### Neni 10

#### Kurorumi





10.1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

10.2. Në rastin kur Asambleja e Përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se 1/2 (gjysmën) e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të Ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

10.3. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorunit, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

## **Neni 11**

### **Marrja e vendimeve**

11.1. Asambleja e përgjithshme vendos me  $\frac{3}{4}$  (tri të katërtat) e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

11.2. Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si: përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë; emërimin dhe shkarkimin e administratorëve; emërimi dhe shkarkimi i likuiduesve dhe i ekspertëve kontabël të autorizuar; përcaktimi i shpërblimeve; mbikëqyrja e zbatimit të politikave tregtare nga administratori, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë; përfaqësimi i shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorit; miratimi i rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

çështje të tjera të miratuara nga ligji apo statuti;


11.3 Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB .

## **Neni 12**

### **Administrimi**

12.1. Shoqëria do të administrohet nga një administrator .

12.2. Personi përgjegjës për administrimin dhe përfaqësimin e shoqërisë është administrator i shoqërisë Z. Erland Mara, lindur më 28.04.1992, banues në Tiranë, i identifikuar nga Pasaporta me Nr.J20428091E.Kompetencat e përfaqësimit janë të plota duke i dhënë tagër përfaqësuesit të përfaqësojë shoqërinë në të gjitha marrëdhëniet juridike apo veprimet juridike, në të cilat shfaqet shoqëria.





- 12.3. Administratori do të ushtrojë detyrat sipas statutit dhe ligjit për një periudhë 5 (pesë) vjeçare me të drejtë ripërtëritje .
- 12.4. Emërimi i administratorit prodhon efekte pas regjistrimit në QKR.
- 12.5. Tagrat e përfaqësimit të administratorit dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.
- 12.6. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme.
- 12.7. Administratori mund t'u delegojë personave të tretë të caktuar prej tij, një pjese apo të gjitha kompetencat e tij, me anë të një prokure e cila është objekt aprovimi nga Asambleja e Ortakëve me shumicë prej 60 %. E njëjta procedurë ndiqet edhe për revokimin e kësaj prokure.

### **Neni 13**

#### **Kompetencat**

- 13.1 Administratori ka të drejtë e detyrohet të: kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme; përfaqësojë shoqërinë tregtare; kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë; përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim; krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë; kryen regjistrimet dhe dërgon të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit; raporton përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare; kryen detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
- 13.2. Të thërrasë asamblenë e përgjithshme edhe në rastet :
- sipas bilancit vjetor, raporteve të ndërmjetme financiare, ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim; shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- 13.3. Të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm.
- 13.4. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjithë personave fizike e juridikë, publikë dhe/ose privatë vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të të gjitha shkallëve.





13.5. Ka të gjitha kompetencat të veprorë në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji i jep shprehimisht ortakëve.

13.6. Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

13.7. Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i Administratorit/ëve e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

## Neni 14

### Përgjegjësitë

14.1. Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.


14.2. Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

14.3. Përveç parashikimit në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:

I. Të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis; të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita; të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim; të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë; të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

II. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

III. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1,2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidarë.





IV. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:

- u kthen ortakëve kontributet;
- u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- u shpërndan aktivet shoqërisë;

lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet; jep kredi.

V. Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit.

VI. Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme.

VII. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë-padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

Administratori mund të shkarkohet në çdo moment, me vendim të Asamblesë së Ortakëve, të aprovuar nga një ose më shumë ortakë që përfaqësojnë 60% të kapitalit të shoqërisë, me vendim të autoritetit gjyqësor shqiptar, për shkelje të ligjit.

## Neni 15

### Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përbashimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

## Neni 16

### Bilanci i shoqërisë dhe dividendët

16.1. Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

16.2. Shoqëria mund t'u shpërndajë fitime ortakëve, vetëm nëse pas pagimit të dividendit:





aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj; shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.

16.3. Administratori lëshon një çertifikatë të aftësisë paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shpërndarja e propozuar e dividendëve përmbush kërkesat e paragrafit 2, të këtij neni, ndërsa kur gjendja e shoqërisë tregon se shpërndarja e propozuar e dividendëve nuk i përmbush këto kritere, administratori nuk mund ta lëshojë këtë çertifikatë.

16.4. Pas plotësimit të parashikimeve të paragrafit 2 të këtij neni, shoqëria me shumicë të kualifikuar të votave të Asamblesë së Përgjithshme mund të deklarojë shpërndarjen e dividendëve në raport me kuotat e zotëruara.

## **Neni 17**

### **Ekspertët**

17.1. Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko-tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

17.2. Në përfundim të kontrollit, eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar.

## **Neni 18**

### **Shpërndarja ose prishja e shoqërisë**

18.1. Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë: kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj; me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve; me hapjen e procedurave të falimentimit; nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit"; me vendim të gjykatës;

18.2. Në këtë rast,Ortakët marrin vendim me shkrim, ku parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1/disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuiduesit dhe emërtesën shtesë " Shoqëri në likuidim e sipër".

18.3. Prishja e shoqërisë ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.





18.4. Rregullat për procedurën e zakonshme të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese janë nenet 191 deri në 203 të Ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

18.5. Shoqëria likuidohet me procedurë të thjeshtëzuar, në përputhje me nenet 204 dhe 205 të Ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

## Neni 19

### Baza Ligjore

19.1. Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislationit shqiptar.

19.2. Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

## Neni 20

### SEKRETI

Informacioni , dokumentacioni , sistemet , paisjet , programet , produktet , teknologjia platformat , projektet , etj si dhe cdo gje tjeter qe i perket shoqerise Mbrojtje Siguri Inteligjence shumica konsiderohet sekret dhe jane te grupuara ne dy kategori :

#### 1-Te Klasifikuara


#### 2-Te Paklasifikuara

Kategoria e Klasifikimit behet me akt nenligjor .

Kategorizimi behet sipas rregullores se brendshme dhe aksesit ne to behet nepermjet nivelit te ID ku percaktohet Niveli i Aksesit per cdo punojes .

Aksesi per cdo individ , kompani , institucione shteterore , institucione private dhe nderkombetare , etj qe kerkon akses ne Informacionin , dokumentacionin , sistemet , paisjet , programet , produktet , teknologjine , platformat , projektet , etj si dhe cdo gje tjeter qe i perket shoqerise Mbrojtje Siguri Inteligjence , ky akses jepet ose refuzohet me vendim te vecante sipas rregullores se brendshme .

Aksesi kerkohet me kerkese ne formatin e miratuar me vendim . Brenda 30 diteve nga marrja e kerkeses njoftohet kerkuesi nqs i miratohet kerkesa dhe i vendoset niveli i aksesit ose i refuzohet aksesit .





## Neni 21

### FUNKSIONIMI

Aktet nenligjore per funksionimin e shoqerise do te miratohen mbas themelimit te shoqerise dhe duke filluar nga data e regjistrimit te saj ne QKB .

## Neni 22

### Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jenë kompetente gjykatat shqiptare, sipas Kodit të Procedurës Civile në R.Sh.

## Neni 23

### Dispozita e fundit

23.1.Statuti hyn në fuqi me regjistrimin e tij pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit .

23.2. Ky Statut hartohet në 3 ( tre ) ekzemplarë me përmbajtje të njëjtë juridike , në gjuhën shqipe , miratohet dhe nënshkruhet në të gjitha kopjet nga Ortaku themelues i shoqërisë "MBROJTJE SIGURI INTELIGJENCË" SH.P.K.

Miratuar me vendimin e ortakut te vetem **Datë 28/01/2021**

**ORTAKU**

**ERLAND MARA**

